



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 908/3 prot.

Tiranë, më 15. 07. 2024

V E N D I M

Nr.202, Datë 15.07. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 144 Regj, datë 27.06.2024, të paraqitur nga znj.A.H , kundër gazetarëve të emisionit “Stop” transmetuar në Tv Klan, O.Gj , S.K dhe G.Z , në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja znj.A.H , parashtron:

“Quhem A.H , me profesion notere pranë qytetit të Fierit (bashkëlidhur formularit liçenca që ushtroj profesionin). Jam diskriminuar për shkak të profesionit si notere (çdo shkak tjetër). E drejtoj këtë ankesë kundër Emisionit Investigativ “STOP”, në televizionin Klan, i cili në mënyrë të padrejtë ka realizuar një emision me fakte të deformuara duke diskredituar e denigruar personalitetin tim si notere (çdo shkak tjetër, profesioni që ushtroj) dhe ka ulur besimin e qytetarëve ndaj organeve të reja drejtuese.

Ankesën e drejtoj së pari për gazetaren O.Gj , për prezantimin e saj arrogant, fyes dhe aspak etik në zyrën time noteriale, në prezencë të klientëve që po merrnin asistencë noteriale, ku me arrogancë dhe mungesë etike ka kryer veprime fyese ndaj meje.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Së dyti, ankimimin e drejtoj ndaj drejtuesve të emisionit “STOP”, S.K dhe G.Z , të cilët mbi faktet e montuara nga gazetarja O.Gj dhe Gent Angjellari, kanë përgatitur disa emisione denigruese për personalitetin tim dhe kanë disinformuar publikun me gjysmë të vërteta në këtë emision.

Ankimimin tim e mbështes konkretisht në Ligjin kundër Diskriminimit dhe më konkretisht:

- a- Më kanë krijuar shqetësim për shkak të profesionit që unë ushtroj (çdo shkak tjetër) në formë diskriminimi, që ka ndodhur si pasojë e një sjellje të padëshiruar, që lidhen me shkaqe të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar.*
- b- Kanë përdorur dhe konsumuar gjuhë urrejtje me formën e shprehjes në publik kundër personalitetit tim.*

Shkeljet e bëra:

Kanë shkelur brutalisht Kodin e Transmetimit, i cili normon me rregulla parimet etike që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, respektimin e privatësisë, dinjitetit etj, me rregullimin e veprimtarisë audiovizive në tërësi të subjekteve.

Ata kanë shkelur të drejtat për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale (për të gjitha faktet e përmendura në lidhje me këto të drejta kam ankimuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale). Ata kanë shpërndarë informacione tek publiku, duke përfshirë këtu përgjime, rregjistrime me kamera, fotografi për jetën private individuale dhe punën publike si notere, pa pëlqimin tim. Gazetarët e emisionit Stop kishin për detyrim ligjor dhe profesional për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen me rolet publike që mbajnë ose kërkojnë.

Në veçanti gazetarja O.Gj ka abuzuar me të drejtën që përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacione për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

Kjo gazetare, me veprimet e saj të kundraligjshme, ka shkelur frymën e përcaktuar në Kushtetutë që është shprehur qartë në legjislacionin specifik të miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë në ligjin nr.8503, datë 30.06.1999 ‘për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare’ dhe ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të shtatorit 2014, i cili ka përmirësuar shumë aspektet të ligjit paraardhës dhe ka krijuar procedura efektive për aksesin e qytetarëve në të dhënat me karakter publik, dhe rrit më tej transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve qendrore dhe vendore.

Gazetarja në vend që të paraqiste në zyrën noteriale formularin e plotësuar me kërkesat për informacion, të cilat unë si notere do ti ktheja përgjigje sipas ligjit, hyn në zyrë në mënyrë arrogante, përdor fjalë jo etike, ndonëse e këshilloj që po punoj me klientët, sipas orareve të përcaktuara më parë, ajo vazhdon me sjellje arrogante duke më fyer mua dhe klientët që po merrnin shërbimin.

Pra, gazetarja ka shkelur ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që ka për qëllim të garantojë të drejtën e qytetarëve për tu njohur me informacionin me karakter publik, të vënë në dispozicion nga autoritetet publike. Ky ligj përcakton rregullat e posaçme për rregullimin e marrëdhënies së institucioneve publike me qytetarët në kuadrin e dhënies së informacionit që konsiderohet publik, duke lehtësuar aksesin e këtyre të fundit në këtë informacion dhe nxitjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Gazetarja me ndërhyrjen e saj dhe kronikën televizive të montuar keq, ka përdorur rregjistrime të fshehta dhe ka shkelur nenin 8 KEDNJ- E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

Gazetarja ka krijuar një kronikë televizive me rregjistrimet e fshehta të zhvilluara në seancën gjyqësore duke shkelur përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale për seancat dëgjimore. Për sa i përket seancave dëgjimore, ato janë publike dhe mund të ndiqen nga gazetarët. Gjatë seancave, gazetarët luten të mbajnë telefonat fikur. Gjithsesi, në çdo moment, kryesuesi i trupës gjyqësore mund ta kufizojë apo ta ndalojë një komunikim të tillë, nëse ai do të pengojë hetimin apo zhvillimin e rregullt të procesit të seancës. Gjatë zhvillimit të seancave ndalohet rreptësisht kryerja e regjistrimeve me zë apo edhe me figurë. Ky ndalim gjen zbatim edhe për sa i përket regjistrimeve që mediat kërkojnë të kryejnë në zonat publike të ndërtesës së KPK-së, përveç rasteve kur një kërkesë për të kryer regjistrime është miratuar nga koordinatori për mediat në KPK, i cili mund të vendos kushte për dhënien e lejes nga ana e KPK-së.

Drejtuesit e emisionit Stop, i kanë deformuar më tej këto informacione të pavërteta dhe i kanë transmetuar në publik pa i verifikuar, duke krijuar së bashku një grup të përbashkët për tu ankimuar.

Nga e gjithë kjo situatë që parashtrova, është denigruar imazhi im si person dhe si notere, e cila është pasqyruar dhe në rënien e punës në zyrën ku unë ushtroj profesionin.”

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen e masave ligjore siç parashikon ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për të vendosur dinjitetin si dhe sanksione ligjore ndaj gazetarëve për të cilët është paraqitur ankesa.

Ankuesja informon gjithashtu se, aktualisht ka depozituar dy kallëzime penale me objekt “Ndërhyrja e padenjë në jetën private, shpifje, dhënie dhe shpallje të të dhënave në kundërshtim me ligjin” si dhe “Krijimi i provave të rreme me qëllim që të bëhen ndjekje penale dhe të ulet besimi i

opinionit qytetar mbi organet e reja të drejtësisë”, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ankuesja A.H , ushtron funksionin si notere në qytetin e Fierit, në bazë të liçencës me nr.450, lëshuar në datë 2014/01/08, nga Dhoma Kombëtare e Noterëve.

Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga ankuesja³, rezulton se, në emisionin investigativ “Stop”, transmetuar në Tv Klan, emision i cili drejtohet nga gazetarët S.K dhe G.Z , janë transmetuar në datë 30.03.2023 dhe 30.05.2024, kronika të përgatitura nga gazetarja e këtij emisioni O.Gj , që lidhen me veprimtarinë e ankueses në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj si notere.

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në të cilën pretendon se është diskriminuar në formën e shqetësimit dhe gjuhës së urrejtjes, për shkak të profesionit si notere, nga gazetarët e emisionit “Stop”, transmetuar në Tv Klan, O.Gj , S.K dhe G.Z .

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

³ <https://www.youtube.com/watch?v=tAp2tyZwagA&t=315s>

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”,* si dhe *“ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.⁴ GJEDNJ, në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

⁴ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma (neni 3, LMD), ndër të cilat, në formën e “Gjuhës së urrejtjes”, e cila referuar nenit 3, pika 8, të LMD, është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji, si dhe në formën e “Shqetësimit”, që në referim të pikës 13, të nenit 3, të KMD, është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Referuar parashtrimeve të bëra në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, rezultoi se, pretendimet e ankuses në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, nuk përfshihen në ndonjë prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga neni 1, i LMD-së. Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, ankuesja ka identifikuar në formularin e ankuses “*çdo shkak tjetër*” dhe ka parashtruar se, shkakun e pretenduar prej saj si shkak diskriminues në kuadër të përcaktimit “*çdo shkak tjetër*”, në nenin 1, të LMD, është profesioni si notere i ushtruar nga ana e ankuses.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të profesionit si notere, ankuesja parashtron se, gazetarët e emisionit Stop, në TV Klan, O.Gj , me prezantimin e saj arrogant, fytes dhe aspak etik në zyrën e saj noteriale, në prezencë të klientëve që po merrnin asistencë noteriale, me arrogancë dhe mungesë etike ka kryer veprime fyese ndaj ankueses dhe drejtuesit e këtij emisioni, S.K dhe G.Z , mbi fakte të montuara nga gazetarja O.Gj dhe Gent Angjellari, kanë përgatitur disa emisione denigruese për personalitetin e saj dhe kanë disinformuar publikun me gjysmë të vërteta në këtë emision, e kanë diskriminuar ankuesen në formën e shqëtësimit, për shkak të profesionit si notere të ushtruar nga ana e saj, si dhe kanë përdorur dhe konsumuar sjellje diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, nëpërmjet shprehjes në publik të kronikave.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkak i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një *karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.*⁵ Gjykata ka theksuar se fjalës "shkak/status tjetër" në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁶ Interpretimi i këtij nocioni "nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme"⁷.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e parashtruara, Komisioneri nuk identifikon trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm të ankueses, që bazohet apo ka si shkak profesionin si notere të ushtruar nga ankuesja. Gazetarët e emisionit Stop, i cili është një emision investigativ, gjatë të cilit denoncohen raste dhe situata, që sipas gazetarëve janë të padrejta dhe në shkelje të ligjit, kanë realizuar dhe transmetuar nëpërmjet medias audiovizive TV Klan, media në të cilin transmetohet ky emision, kronika dhe informacione që lidhen me mënyrën e ushtrimit të profesionit si notere nga ana e ankueses. Referuar kronikave të ndryshme të transmetuara publikisht nga emisioni Stop, në TV Klan, konstatohen kronika të ngjashme investigative të realizuara dhe të publikuara në kuadër të këtij emisioni, ku përfshihen profesione të fushave të njëjta ose të ngjashme, të drejtësisë si, gjyqtarë, prokurorë, përmbaues gjyqësor, por jo vetëm.

Bazuar në standartet e mësipërme si dhe pretendimet dhe provat e depozituara nga ankuesja në lidhje me shkaun e pretenduar të diskriminimit, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se

⁵ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

⁶ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

⁷ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

është diskriminuar për shkak të profesionit si notere, bazuar në faktet dhe rrethanat konkrete të çështjes objekt shqyrtimi, nuk përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi sipas nenit 1, të LMD.

Shkeljet që ankuesja pretendon se janë konsumuar nga ana e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, duhet të adresohen, sikurse edhe ankuesja parashtron se ka bërë, pranë institucioneve të tjera që janë përgjegjëse për shqyrtimin e tyre. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm i pretenduar, konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ngritura nga pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, në mungesë të një shkakut të ndaluar/mbrojtur diskriminimi, nuk përfshihen në fushën e veprimit të LMD.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesja A.H ka paraqitur kundër gazetarëve të emisionit Stop, Tv Klan, O.Gj , S.K dhe G.Z , për sa kohë që ato nuk përbëjnë pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr.144 datë 27.06.2024, e paraqitur nga ankuesja A.H kundër gazetarëve të emisionit Stop, Tv Klan, O.Gj , S.K dhe G.Z , nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.144, datë 27.06.2024, të paraqitur nga ankuesja A.H kundër gazetarëve të emisionit Stop, Tv Klan, O.Gj , S.K dhe G.Z , pasi nuk plotësohen kriteret

përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim